



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 795/4 prot.  
2023

Tiranë, më 28. 12.

**V E N D I M**

**Nr. 266, datë 28. 12. 2023**

Bazuar në nenin 32/1/b dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën<sup>1</sup> nr. 134, datë 29.06.2023, të Qendrës për Advokim Social<sup>2</sup>, në cilësinë e përfaqësueses së nxënësve A. A., O. G., A. G., B. T., K. Z. dhe A. Z., kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit<sup>3</sup> dhe Bashkisë Tiranë<sup>4</sup> me pretendimin për diskriminim, për shkak të racës, ngjyrës, etnisë, gjendjes ekonomike, gjendjes arsimore, gjendjes familjare dhe përkatësisë në një grup të veçantë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, subjekti ankues në mes të tjerash informon se, gjatë viteve 2019-2022, në zbatim të VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, fëmijët e familjeve në

<sup>1</sup> Plotësuar nga Qendra për Advokim Social më datë 12.07.2023.

<sup>2</sup> Në vijim do ti referohemi me akronimin QAS.

<sup>3</sup> Në vijim do ti referohemi me akronimin MAS.

<sup>4</sup> Në vijim do ti referohemi me akronimin Bashkia.

nevojë që ndiqnin arsimin 9 vjeçar dhe atë të mesëm, përfitonin nga trajtimi financiar me bursë. Prej vitesh kjo VKM është zbatuar duke trajtuar kategoritë e: fëmijëve të cilët kanë statusin e jetimit, fëmijëve të policëve të rënë në detyrë, fëmijëve që kanë probleme me shikimin dhe dëgjimin dhe paraplegjikët. Pas ndryshimeve të pësuara në korrik të 2022, pika 2.1, germa c) e VKM-së së sipërcituar, trajton me bursë fëmijët e familjeve në nevojë të cilët për arsye ekonomike nuk frekuentonin në mënyrë të rregullt arsimin bazë.

Pavarësisht ndryshimeve të pësuara, sipas QAS, nga monitorimet e zhvilluara gjatë vitit shkollor 2022-2023, kanë konstatuar se në disa shkolla 9 vjeçare të qytetit të Tiranës, fëmijët të cilët vinin nga familje në nevojë dhe nga familje që i përkisnin pakicave rome dhe pakicave egjiptiane, nuk përfitonin nga VKM-ja e sipërcituar, pasi nga ana e Bashkisë Tiranë kishte paqartësi në zbatimin e saj, sa i përket faktit se cilat familje do të konsideroheshin në nevojë dhe çfarë dokumentacioni duhet të plotësonin.

Sakaq, QAS ka konstatuar se:

- Në shkollën 9 vjeçare “Betim Muço”, nuk i është pranuar dokumentacioni për trajtimin me bursë nxënësit A. A.<sup>5</sup>;
- Në shkollën 9 vjeçare “Shyqyri Peza”, nuk i është pranuar dokumentacioni për trajtimin me bursë nxënësve O. G.<sup>6</sup>, A. G.<sup>7</sup> dhe B. T.<sup>8</sup>;
- Në shkollën 9 vjeçare Yzberish, nuk i është pranuar dokumentacioni për trajtimin me bursë nxënësve K. Z.<sup>9</sup> dhe A. Z.<sup>10</sup>;

Nga komunikimet që kanë mbajtur me stafin arsimor të shkollave të sipërcituara, QAS pretendon se janë bërë me dije se stafi pedagogjik ishte njoftuar që të vijonte me trajtimin e rasteve të bursës sipas bazës së vjetër ligjore, asaj të 2019. QAS ka pretenduar gjithashtu se shkollat nuk kanë pranuar dosjen me dokumentacionin përkatës për fëmijët e familjeve në nevojë për shkak të urdhërit që kishin marrë duke sqaruar se përsëri ndryshimet VKM-së nuk i përfshinin si kategori përfituese fëmijët e familjeve të cituara më lart.

Në përfundim, QAS kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e MAS dhe Bashkisë Tiranë, të familjeve në nevojë si rezultat i mos përfshirjes së tyre në përfitimin e bursës, si dhe hartimin e një urdhëri apo udhëzuesi për mënyrën se si do të zbatohet VKM-ja Nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”*, e ndryshuar, për kategoritë përfituese si familje në nevojë.

---

<sup>5</sup> Klasa e 4 (katër)

<sup>6</sup> Klasa e 9 (nëntë)

<sup>7</sup> Klasa e 6 (gjashtë)

<sup>8</sup> Klasa e 7 (shtatë)

<sup>9</sup> Klasa e 8 (tetë)

<sup>10</sup> Klasa e 7 (shtatë)

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 134, datë 29.06.2023, të bërë nga Qendra për Advokim Social, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 795/1 prot., datë 17.07.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 32, pika 2, ka kërkuar nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Bashkisë Tiranë, shkollës 9-vjeçare “Betim Muço”, shkollës 9-vjeçare “Shyqyri Peza” dhe shkollës 9-vjeçare Yzberish, që të jepen parashtrime lidhur me të gjitha pretendimet e ngritura, nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën<sup>11</sup> Nr. 4608 prot., datë 04.08.2023, informoi ndër të tjera se: “...1. Sipas vendimit nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe për përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave dhe të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, i ndryshuar, (në vijim referuar “VKM nr. 666, datë 10.10.2019”) nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera nga buxheti i miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin profesional.

Për përfitim të bursave dhe përfitimeve të tjera nxënësit duhet të ndjekin arsimin parauniversitar, me kohë të plotë, pranë institucioneve arsimore publike, si dhe miratimi i tyre bëhet brenda kuotave dhe sipas kriterëve të cilat grupohen në katër kategori, të përcaktuara në pikat 2.1-2.4 të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, i ndryshuar, përkatësisht: 2.1 kriteri ekonomik; 2.2 kriteri i rezultateve të arritura; 2.3 kriteri joekonomik dhe 2.4 kriteri i degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm.

Në pikën 30 të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, i ndryshuar, parashikohet: “30. Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, jep jo më pak se 1200 (një mijë e dyqind) bursa”.

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit (në vijim referuar MAS), në zbatim të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, i ndryshuar, i është drejtuar bashkive me shkresat e poshtëshënuara:
  - 2.1. Me shkresën nr. 6478 prot., datë 07.10.2022, i ka njoftuar për planifikimin e fondeve nga ana e saj për bursa për nxënësit duke i kërkuar bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës ndër-institucionale për shpalljen/publikimin e kërkesave, kriterëve, procedurave dhe

<sup>11</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 915 prot., datë 07.08.2023

- afateve për aplikimin për bursa nga të gjithë subjektet e interesuar dhe sipas kritereve të përcaktuara në VKM nr. 666, datë 10.10.2019, e ndryshuar. Gjithashtu i është kërkuar që të dërgojnë në MAS parashikimin/planifikimin për numrin e bursave që përfitojnë nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar, me kohë të plotë, në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2022-2023, brenda datës 31.10.2022.*
- 2.2. Me shkresën nr. 6478/40, datë 01.11.2022, i është dërguar plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, 2022-2023, për 29 bashki.*
- 2.3. Me shkresat nr. 248 prot., 12.01.2023 dhe nr. 2924 prot., datë 04.05.2023, MAS ka kërkuar informacion në lidhje me bursat e miratuara me vendim të këshillit bashkiak të njëjësive të qeverisjes vendore për vitin shkollor 2022-2023, në kuadër të raportimit çdo tre mujor, për numrin e nxënësve të arsimit parauniversitar që trajtohen me bursa dhe me kuota ushqimore në konvikte si dhe për fondet buxhetore të shpenzuara.*
- 3. Nga dokumentacioni lidhur me bursat për nxënësit të cilët ndjekin arsimin parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2022-2023, rezulton se:*
- 3.1. Bashkitë: Krujë, Këlcyrë, Memaliaj, Tropojë, Malësi e Madhe dhe Finiq nuk kanë dërguar në MAS parashikime për numrin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2022 -2023.*
- 3.2. Bashkitë: Libohovë, Pustec, Kavajë, Lezhë, Dropull, Belsh, kanë informuar se nuk kanë miratuar bursa për nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023*
- 3.3. Bashkitë: Himarë, Dimal, Patos, Rrogozhinë, Pogradec, Cërrik, Roskovec, Bulqizë, Lushnje, Peqin, dhe fillimisht Bashkia Lezhë, për vitin shkollor 2022-2023, kanë miratuar vetëm bursa për nxënësit që ndjekin arsimin e mesëm profesional të cilat nuk janë në përgjegjësinë e MAS por të ministrisë përgjegjëse për arsimin profesional, referuar pikës 29 të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, që përcakton: “29. Ministria përgjegjëse për arsimin profesional, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin profesional, të parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi, jep jo më pak se 2500 (dymijë e pesëqind) bursa”.*
- 3.4. Me shkresën e MAS nr. 6478/40, datë 01.11.2022, i është dërguar 29 bashkive, plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023.*
- 3.5. Me shkresën e MAS nr. 6478/60, datë 07.12.2022, i është dërguar Bashkisë Elbasan, plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023.*
- 3.6. Me shkresën e MAS nr. 8144/1, datë 21.12.2022, i është dërguar Bashkisë Lezhë, plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023.*
- 3.7. Me shkresën e MAS nr. 6478/64, datë 21.12.2022, i është dërguar Bashkisë Korçë, plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023.*

4. Bashkia Tiranë me shkresën nr. 35617/1 prot., datë 25.10.2022, drejtuar MAS, ka parashikuar që numri i aplikimeve të cilat mund të rezultojnë me dokumentacion të rregullt dhe plotësojnë kriteret do të jetë rreth 3500. Në shkresë kërkohet bashkëpunimi për një interpretim shterues mbi procedurën dhe kërkesat ligjore që duhet të plotësojnë nxënësit për kriterin 2.1 (c).

MAS, me shkresën nr. 6478/57 prot., datë 01.12.2022 me lëndë “Kthim përgjigje”, e ka sqaruar Bashkinë Tiranë lidhur me shkronjën “c”, e nën pikës 2.1, të pikës 2, të VKM nr. 511, datë 27.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 666, datë 10.10.2019...”, e ka sqaruar si vijon: Pika 1, e projektvendimit parashikon që shkronja “c”, e nën pikës 2.1, të pikës 2, të ndryshohet duke përcaktuar se do të përfitojnë bursa sipas kriterit ekonomik nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë. Ndryshimi i kësaj pike vjen në zbatim të kërkesës nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vijim të kërkesës së subjektit “Qendra T’Reja” që e konsideron pengesë dhe diskriminuese përdorimin e togfjalëshit “braktisje shkollore”, duke lidhur përfitimin e bursave me të qenit braktisës. Për pasojë kriteri vijon të jetë i njëjtë, si vitet e kaluara, pasi vetëm terminologjia ka ndryshuar.”

MAS i ka dërguar Bashkisë Tiranë, 1800 bursa për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023, sipas shkresave nr. 6478/63 prot., datë 21.12.2022 dhe nr. 953/2 prot., datë 14.06.2023.

5. Lidhur me pretendimin e ngritur në ankesën se tre shkolla 9-vjeçare nuk kanë pranuar dokumentacionin për trajtimin me bursë të gjashtë nxënësve të tyre si dhe stafi pedagogjik ishte njoftuar që të vijonte me trajtimin e rasteve të bursave sipas bazës ligjore të vjetër asaj të 2019, sqarohet se bazuar në VKM Nr. 666, datë 10.10.2019, i ndryshuar, aplikimet për bursë dhe përfitime të tjera që marrin nxënësit të cilët ndjekin arsimin parauniversitar në institucionet arsimore publike, bëhen pranë bashkive dhe jo pranë shkollave.

Gjithashtu njësitë e qeverisjes vendore mund të miratojnë dhe shpërndajnë bursa për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, me fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar sipas pikës 5 të VKM nr.666, datë 10.10.2019, që përcakton: “5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, dhe për uljen e braktisjes shkollore të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.”

Bazuar në VKM nr. 666, datë 10.10.2019, e ndryshuar, MAS i kërkon bashkive që t’i dërgojnë planifikimin e bursave si dhe të bëjnë shpalljet dhe njoftimet për të interesuarit që aplikojnë. Bashkitë miratojnë me vendim të këshillave bashkiakë bursat për nxënësit e arsimit parauniversitar duke i akorduar dhe fondin buxhetor përkatës. Bashkitë duhet të raportojnë në MAS, çdo tre muaj, për bursat e nxënësve të arsimit parauniversitar të miratuara me vendime të këshillave bashkiak si dhe për fondet buxhetore të shpenzuara.

Shkollat nuk janë institucione të cilat përfshihen në procedurën lidhur me bursat e nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar. Nga dokumentacioni i administruar lidhur me çështjen dhe i

cituar në përmbajtjen e kësaj shkrese, rezulton se gjithë korrespondenca zyrtare lidhur me bursat është midis MAS dhe bashkive si dhe nuk rezulton asnjë korrespondencë mes MAS dhe shkollave në përgjithësi si dhe mes MAS dhe tre shkollave, në veçanti, të përmendura në ankesë.

Sipas VKM nr. 666, datë 10.10.2019, i ndryshuar, shkollat ngarkohen vetëm me detyrimin e dhënies së informacionit lidhur me frekuentimin e shkollës sipas pikave 4 dhe 16, të tij, ku përcaktohet: “4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollë, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar.

16. Për nxënësit, të cilët kanë përfituar bursë, drejtorët e shkollave të arsimit profesional si dhe të shkollave të tjera të arsimit parauniversitar, dërgojnë zyrtarisht, në datën 5 të çdo muaji pranë njërive të vetëqeverisjes vendore, informacion për frekuentimin e shkollës/praktikës profesionale nga nxënësit që përfitojnë bursë.”

Përsa më sipër, MAS i ka realizuar dhe përmbushur të gjitha përgjegjësitë në lidhje me bursat për nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar, në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2022-2023, brenda kuotave dhe kritereve të përcaktuara në VKM nr. 666, datë 10.10.2019, i ndryshuar, si dhe nuk ka kryer asnjë veprim që të rezultojë diskriminues për asnjë nga shkaqet e pretenduara në ankesë.

Përfundimisht MAS kërkon rrëzimin e ankesës pasi e vlerëson të pabazuar në ligj dhe në prova.”

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Bashkia Tiranë, me shkresën<sup>12</sup> Nr. 26164/1 prot., datë 02.08.2023, informoi ndër të tjera se: “...Bashkia Tiranë në respektim të çdo afati ligjor të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, (i ndryshuar), realizoi njoftimin për fillimin e procedurave të aplikimit për trajtimin me bursë nga fondi i bursave të shtetit për nxënësit, referuar kritereve dhe kushteve ligjore që duhet të plotësojnë qytetarët për të përfituar këtë bursë, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.

Në zbatim të VKM-së nr. 511, datë 27.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, i ndryshuar”, Bashkia Tiranë ka vijuar punën për shqyrtimin e ndryshimeve dhe shtesave të miratuara në VKM-në e sipërcituar, me qëllim pasqyrimin e tyre në listën e dokumentacionit që duhet të plotësojnë nxënësit për të përfituar këtë bursë si dhe procedurat e aplikimit sipas kritereve të përcaktuara në VKM nr. 511, datë 27.07.2022. Në përfundim të gjithë këtij procesi, ka rezultuar se kriteri 2.1(c), nuk shpreh qartë kushtet ligjore që duhet të plotësojnë nxënësit/fëmijët që të mund të aplikojnë sipas këtij kriteri

<sup>12</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 913 prot., datë 04.08.2023

dhe është i pazbatueshëm referuar pikës 3, germa c). Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë pse humbasin të drejtën e përfitimit të saj kur deklarohen mbetës apo përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluëse.

Sa më sipër, me synimin e zbatimit me efikasitet maksimal të procesit të përcaktimit të kërkesave, kritereve, procedurave dhe afateve për aplikim për bursa sipas kritereve të përcaktuara, nëpërmjet shkresës me nr. 35617/1 prot., datë 25.10.2022, drejtuar MAS, kemi përcjellë kërkesën për interpretim shterues mbi procedurën dhe kërkesat ligjore që duhet të plotësojnë nxënësit për të përfituar bursë referuar kriterit 2.1 (c).

Përsa më lart, ju bëjmë me dije se, Bashkia Tiranë ka shprehur në vazhdimësi zyrtarisht dhe jo vetëm, por edhe në takime dhe tryeza ndërinsticionale se mbetet e angazhuar dhe e hapur për të bashkëpunuar në kuadër të rishikimit dhe rivlerësimit të formulimit dhe përcaktimit të kritereve dhe kategorive përfituese të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, i ndryshuar, duke vlerësuar përfshirjen e përfaqësuesve të njësive të vetëqeverisjes vendore shumë të rëndësishëm si një nga hallkat kryesore të zbatimit të kësaj VKM-je, në të gjitha proceset e konsultimit dhe hartimit të kritereve dhe procedurave për shqyrtimin, miratimin dhe shpërndarjen e bursave të nxënësve të arsimit parauniversitar.

Në vijim të këtij procesi, ndodhur në limit të afateve ligjore dhe pas asnjë përgjigje zyrtare të MAS, mbi procedurën dhe kërkesat ligjore që duhet të plotësojnë nxënësit për të përfituar bursë referuar kriterit 2.1 (c), Bashkia Tiranë ka vijuar me miratimin e listave me 1200 nxënës të arsimit parauniversitar të përgjithshëm në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa, brenda planit të miratuar për vitin shkollor 2022-2023, si më poshtë:

- Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 133, datë 23.12.2022 “Për miratimin e listave të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa dhe pagesa, për vitin shkollor 2022-2023”.
- Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 13, datë 25.01.2023 “Për miratimin e listave të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa dhe pagesa, për vitin shkollor 2022-2023”.

Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi numrin e bursave të miratuara para ndryshimeve të VKM nr. 666/2019, ju sqarojmë gjithashtu se, për vitin shkollor 2021-2022 Bashkia e Tiranës ka miratuar listën me 1200 (njëmijë e dyqind) nxënës të arsimit parauniversitar të përgjithshëm në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa, brenda planit të miratuar për vitin shkollor 2021-2022, si më poshtë:

- Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 172, datë 24.12.2021 “Për miratimin e listave të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa dhe pagesa, për vitin shkollor 2021-2022”.

Sa më sipër sqarojmë se, për arsye se kuotat për Bashkinë Tiranë për vitin shkollor 2022-2023 nuk janë rritur, janë 1200 (njëmijë e dyqind) bursa, njësoj me vitin e kaluar shkollor, pavarësisht ndryshimeve dhe shtesave të kategorive përfituese të miratuara me VKM nr. 511, datë 27.07.2022, të cilat nuk ishin të parashikuara në kuotat para ndryshimeve ligjore...”.

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, MAS dhe Bashkia Tiranë vunë në dispozicion të Komisionerit kopje të provave bashkëngjitur sa i përket pretendimeve të ngritura në shkresat respektive.

2. Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 134, datë 29.06.2023, Komisioneri me shkresën nr. 795/3, datë 26.09.2023 njoftoi palët dhe KM, MAS, Bashkinë Tiranë, për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 05.10.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe pretendimet e palëve në proces.

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palëve në proces: përfaqësuesja e Qendrës për Advokim Social, znj. R. S. dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa: përfaqësuesve me autorizim nr. 4608/3, datë 02.10.2023, të MAS, znj. I. N.; përfaqësueses së Bashkisë Tiranë, znj. A. L. Ndërsa nga ana e Këshillit të Ministrave nuk u paraqit asnjë përfaqësues.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, si dhe deklaroi se: *“Mendojmë se shkaqet e racës, ngjyrës, etnisë kanë ndikuar në sjelljen diskriminuese si pasojë e mospranimit nga ana e shkollave të dokumentacionit të dorëzuar nga prindërit për përfitimin e bursave, si dhe sjelljes dhe qëndrimit të mbajtur nga ana e përfaqësuesve të tyre gjatë këtij procesi me prindërit (ankuesit) të cilët vijnë nga pakicat rome dhe egjiptiane”*.

Në vijim gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Bashkisë Tiranë theksoi ndër të tjera se: *“Lidhur me nocionin “familje në nevojë”, bashkia e ka të qartë se kush përfshihet në këtë grup, pra kryesisht familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike. Problematika qëndron në paqartësinë e VKM-së nr. 511/2022 të ndryshuar, në të cilën është hequr termi “braktisje” dhe në përmbajtje ajo ka mbetur e njëjtë duke bërë ndryshime vetëm në terminologji. Paqartësia qëndron në faktin se duke analizuar pikën 2.1 c), nuk del e qartë se çfarë dokumentacioni duhet të dorëzojnë aplikantët për të përfituar bursë si nxënës që vijnë nga familje në nevojë dhe janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë. Pjesa e parë e fjalisë është e qartë në këtë dispozitë, pasi në grupimin e familjeve në nevojë së paku konsiderohen familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, ndërsa pjesa tjetër e fjalisë që lidhet me pamundësinë e ndjekjes së arsimit, nuk është e qartë pasi mbetet në të njëjtin kuptim si më parë, përpara ndryshimit të VKM-së, kur i referohej me braktisje dhe nxënësit duhet të mosfrekuentonin mësimin për të qenë përfitues të bursës. Për këtë arsye, Bashkia Tiranë i është drejtuar disa herë MAS duke kërkuar interpretimin e saj, po nuk ka marrë një përgjigje konkrete. Gjithashtu, duke parë ndryshimet e bëra në VKM-në përkatëse dhe shtimin e kategorive përfituese, Bashkia Tiranë i ka kërkuar MAS shtimin e numrit të kuotave për përfitimin e bursave, por nuk ka ndodhur një gjë e tillë, duke*



*vijuar me të njëjtat kuota si më parë, pra 1200. Bashkisë Tiranë nuk i mungon vullneti për t'i bërë pjesë të përfitimit të bursave edhe ankuesit, apo personat që ndodhen në të njëjtat kushte me ta, por e ka të pamundur pasi, nuk është e qartë për dokumentacionin që prodhon VKM-ja, pika 2.1 c) dhe nuk i mbulon me buxhetin e parashikuar për vitin 2023. Për vitin 2024, po diskutohet rishikimi i buxhetit ku të parashikohen edhe kuotat për bursat e parashikuara në këtë VKM.”*

MAS dhe Bashkia Tiranë theksuan gjatë seancës dëgjimore se drejtuesit e shkollave nuk kanë asnjë tagër për të vendosur lidhur me përfitimin ose jo të bursave të nxënësve. Detyrimi i përfaqësuesve të shkollave lidhet vetëm me mbledhjen e dokumentacionit dhe përcjelljen e tij në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesja e MAS-it informoi ndër të tjera se: *“Pas ndryshimeve të pësuara në VKM nr. 666/2019, ndryshuar me VKM-në nr. 511/2022, pika 2.1 c) është riformuluar dhe sipas MAS nuk ka më paqartësi lidhur me zbatimin e saj.”*

Në përfundim të seancës, nga ana e Komisionerit u kërkua që Bashkia Tiranë të vërë në dispozicion informacionin lidhur me numrin e aplikantëve për bursa dhe ndarjen e tyre sipas kategorive përfituese të VKM-së 666/2019 të ndryshuar.

3. Lidhur me plotësimin e kërkesave të parashtruara gjatë seancës dëgjimore nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Bashkia Tiranë përmes e-mail-it<sup>13</sup> datë 05.12.2023, sqaroi ndër të tjera se: *“Aplikime për bursë për të gjitha kategoritë janë 2100. Janë kualifikuar si përfitues të bursës deri sot 1632 me dokumentacion të rregullt dhe që plotësojnë kriteret e VKM 666 të ndryshuar. (procedura e shqyrtimit vazhdon)*

*Aplikantë sipas kriterëve 2.1 a, b, nxënës që vijnë nga familje me Ndihmë Ekonomike nuk janë kualifikuar si përfitues pasi kriteri në VKM kërkon akomodim në konvikt.*

*Për kriterin 2.1 c) nuk kemi asnjë aplikant të kualifikuar pasi nuk ka asnjë aplikim i cili të jetë pajisur nga shkollat me vërtetimin që janë regjistruar, por nuk frekuentojnë për arsye ekonomike, siç është parashikuar në VKM.*

*Ministria e Arsimit ka sjellë shkresën me miratimin e 1300 kuotave për vitin shkollor 2023-2024. Sërish jemi në situatën e pamjaftueshmërisë së numrit të kuotave. Nisur nga kjo situatë jemi duke parë mundësinë për hapësirë ligjore për të mbuluar me fondet e Bashkisë numurin e kuotave që mbeten pa pagesë nga MAS. Gjithsesi kjo procedurë nga Bashkia do të kalojë në Këshill Bashkiak dhe jemi në shpresë që do të miratohet. Pra, derisa të zhvillohet mbledhja e KB dhe të kalojë propozimi ynë, mbetemi në situatën që ju kam përshkruar më sipër.*

---

<sup>13</sup> Dërguar nga ana e znj. A. L.

*Të ritheksoj që kriteret 2.1 a,b,c në të gjitha situatat mbeten pa pagesë pasi VKM 666 e ndryshuar është shprehur për ta. Bashkia e Tiranës nuk mund të veprojë as me fondet e veta në tejkalim të VKM-së”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.**

Subjekti ankues, pretendon se VKM-ja Nr. 511, datë 27.7.2022 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*”, e ndryshuar, duhet rishikuar, duke trajtuar si kategori përfituese, familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato në nevojë. Referuar pretendimeve të parashtruara nga pala ankuese gjatë shqyrtimit të ankesës dhe seancës dëgjimore, nga Komisioneri u vlerësua se objekti i saj lidhet me përmbajtjen e pikës 2.1 të VKM-së dhe jo me veprimet e ndërmarra nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Bashkia Tiranë dhe institucionet arsimore të cituara në ankesë. Në këtë kuptim, Komisioneri do vijojë trajtimin e ankesës duke analizuar VKM-në nr. 666/2019, të ndryshuar në vitin 2022.

E drejta për arsim, është një e drejtë kushtetuese, e cila duhet të sigurohet mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim pavarësisht nga gjendja ekonomike e personit. E drejta për arsim garantohet edhe në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat vendi ynë i ka ratifikuar duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe të detyrueshme për t’u zbatuar.

Kështu, në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

- 1. Kushdo ka të drejtën për arsimim.*
- 2. .... 3. .... 4. ....*
- 5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.*

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t’u arsimuar. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, sanksionin të drejtën e fëmijës për t’u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta.

Në nenin 28 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës<sup>14</sup>, parashikohet se:

*1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:*

- a) Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;*
- e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.*

<sup>14</sup> Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7531, datë 11.12.1991.

## *Neni 29*

### *1. Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:*

*(a) Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;*

*(b) Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara.*

Ligji 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënësi duhet t’i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

Kështu, në ligjin 69/2012, parashikohet se:

### *Neni 5. E drejta për arsimim.*

- 1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.*
- 2. Në shkollat publike arsimi i detyrueshëm dhe arsimi i mesëm i lartë janë falas.*

### *Neni 6. Parime të përgjithshme.*

- 4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve.*
- 5. Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.*
- 6. Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.*

### *Neni 19. Përkujdesje për kategori të veçanta të nxënësve.*

*Kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti. Format dhe kriteret e përkujdesjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

### *Neni 28. Njësia bazë e qeverisjes vendore.*

- 1. Njësia e vetëqeverisjes vendore, mbështetur në propozimet e institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, sipas kriterëve të miratuara në këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, mbështet: a) nxënësit e familjeve në nevojë; b) nxënësit me arritje të shkëlqyera; c) punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e*

kurrikulës; ç) pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore; d) nxënësit me aftësi të kufizuara.

Në zbatim dhe të legjislacionit të sipërcituar, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimim e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, e ndryshuar.

Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohej se:

2. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kritereve, si më poshtë vijon:

### 2.1 Kriteri ekonomik:

a) nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët ndjekin procesin mësimor në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe që akomodohen në konvikte publike;

b) nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km, të cilët plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, dhe që akomodohen në konvikte publike;

c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, me ndikim në uljen e nivelit të “braktisjes shkollore”, që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.

### 2.2 Kriteri i rezultateve të arritura:.....

### 2.3 Kriteri joekonomik:

a) nxënësit, të cilët kanë përfitur statusin e jetimit;

b) nxënësit, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë;

c) nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik;

ç) nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë;

d) nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit;

dh) nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane, të cilët regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional;

e) nxënësit, të cilët janë identifikuar dhe trajtuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;

ë) nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;

- f) nxënëset (vajza), të cilat ndjekin drejtimet mësimore mekanikë, elektroteknikë, elektronikë, përpunim druri, gjeodezi, shërbim mjete transporti, termo-hidraulikë;
- g) nxënësit me një prind.

Në fillim të çdo viti shkollor, por jo më vonë se muaji nëntor i çdo viti, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet e përkujdesjes sociale rezidenciale publike, për këto kategori nxënësish, duhet të dërgojnë në institucionet arsimore ku ata ndjekin procesin mësimor si dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse listën e nxënësve përfitues sipas pikës 2.3 të këtij vendimi.

2.4 Kriteri i degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm:.....

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, dhe për uljen e braktisjes shkollore të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.

Me Urdhërin nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, MAS në nenin 76 ka përcaktuar se: “Nxënësi braktisës në arsimin bazë.

1. Nxënësi i arsimit bazë konsiderohet potencialisht braktisës nëse është i regjistruar në shkollë në fillim të vitit shkollor dhe në fillim të javës së tretë të muajit tetor raportohet nga shkolla si i paparaqitur.
2. Nxënësi i arsimit bazë konsiderohet braktisës:
  - a) nëse është i regjistruar në shkollë në fillim të vitit shkollor dhe në përfundim të vitit shkollor rezulton i paklasifikuar (mbetës) për shkak të mungesave;
  - b) kur nuk ka mungesa me arsye dhe nuk përmbush asnjë prej kushteve përjashtuese: fatkeqësisë familjare, sëmundje që zgjat shumë ose shkakton mungesa të rregullta (dokumentuar me raport mjeko-ligjor), transferimi në një shkollë tjetër brenda vendit (i dokumentuar), migrimi jashtë vendit (i dokumentuar), vdekja.
3. Drejtori i IA-së së arsimit bazë njofton me shkresë titullarin e ZVA-së dhe personin që ushtron përgjegjësinë prindërore për nxënësit që i përket shkollës së tij dhe nuk është regjistruar në shkollë, ose për nxënësin që mungon më shumë se 10 ditë mësimi, pa ndonjë arsye të vlefshme. Titullari i ZVA-së njofton me shkresë bashkinë, ku nxënësi banon, me të dhënat e paraqitura nga drejtori i IA-së”.

Qëllimi i përbashkët i akteve ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura është që nëpërmjet tyre të garantohet e drejta e fëmijës për arsim.

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 239, datë 21.12.2021, Komisioneri ka analizuar VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar, duke vlerësuar se fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, janë trajtuar në mënyrë të pafavorshme krahasuar me grupet e tjera si fëmijët me statusin e jetimit, ato me aftësi të kufizuara apo grupet e tjera që përfitojnë prej saj.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me vendimin Nr. 148, datë 22.07.2022, ka konstatuar diskriminimin e fëmijëve të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Këshillit të Ministrave. Në këtë kuadër, Komisioneri i është drejtuar Këshillit të Ministrave të marrë masa, për rishikimin e VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar, duke shtuar trajtimin me bursë pa kushte shtesë, të nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike.

Lidhur me këtë, në zbatim të vendimmarrjes së Komisionerit, Këshilli i Ministrave miratoi VKM-në nr. 511, datë 27.07.2022 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike””*, të ndryshuar, duke bërë përfitues në ndryshimet si më poshtë:

- Pika 2.1 “Kriteri ekonomik”, germa c) ndryshoi si vijon: *“...nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë”....*

Sa i përket ndryshimeve të bëra në VKM-në nr. 666/2019, Ministria e Arsimit dhe Sportit, nëpërmjet shkresës me nr. 4967/1 prot., datë 01.08.2022, informoi Komisionerin lidhur me zbatimin e Vendimit nr. 148, datë 22.07.2022, duke theksuar ndër të tjera, se:

*“... Në VKM nr. 511, datë 27.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike””, të ndryshuar, është parashikuar ndryshimi i shkronjës “c” të nënpikës 2.1, të pikës 2 të vendimit në fuqi duke hequr nga kjo fjali togfjalëshin “me ndikim në uljen e nivelit të “braktisjes shkollore””.*

*Parashikimet e shkronjës “c” të nënpikës 2.1, të pikës 2 të vendimit në fuqi, zbatohen për nxënësit në arsimin bazë në kuadër edhe të parashikimeve të nenit 22, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin*

*arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku i detyrueshëm është arsimi bazë dhe jo arsimi i mesëm i lartë, prandaj edhe politika shtetërore e mbështetjes financiare për këtë kategori lidhet me arsimin bazë”.*

Në vlerësim të ndryshimit ligjor të sipërpërmendur, Komisioneri gjykoj se vendimi i Komisionerit nuk është zbatuar, pasi në thelb përsëri fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike nuk përfitojnë bursë financiare gjatë periudhës që ndjekin mësimin, por duhet të jenë në kushtet që nuk e ndjekin arsimin dhe pastaj të përfitojnë bursë.

Në këtë kuadër, me anë të shkresës nr. 1171 prot., datë 25.08.2022, iu drejtua Këshillit të Ministrave duke kërkuar zbatimin e vendimit të Komisionerit nr. 148, datë 22.07.2022.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Këshilli i Ministrave me shkresën nr. 4305/2 prot., datë 2.9.2022, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...Shkronja “c”, e nënpikës 2.1, të pikës 2, ka ndryshuar si vijon:... përfitojnë bursë...c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.*

*Ky ndryshim u bë në zbatim të kërkesës nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vijim të kërkesës së subjektit “Qendra T’Reja”, që e vlerëson si pengesë dhe diskriminuese përdorimin e togfjalëshit “braktisje shkollore” duke e lidhur përfitimin e bursave me të qenët braktisës. Parashikimi i kësaj pike është bërë me qëllim rritjen e aksesit në arsim, me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit e disavantazhuar. Bursa për fëmijët e familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë por janë në pamundësi financiare, është parashikuar të jepet pikërisht për të mundësuar ndjekjen e arsimin...”.*

Sa më sipër, referuar interpretimit të bërë nga Këshilli i Ministrave, Komisioneri konsideroi të zbatuar vendimin nr. 148, datë 22.07.2022.

Pavarësisht sa më sipër, referuar procedurës së shqyrtimit të ankesës nr. 134, datë 29.06.2023, të depozituar nga Qendra për Advokim Social, u konstatua se nxënësit që vinin nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike si p.sh. nxënësit: A. A., O. G., A. G., B. T., K. Z. dhe A. Z., janë përballur me të njëjtën situatë si përpara ndryshimeve të pësuara të VKM-së nr. 666/2019. Kjo, pasi edhe nga informacioni i administruar nga ana e Bashkisë Tiranë, u evidentua se ishin të paqartë në zbatimin e VKM-së nr. 666/2019, ndryshuar në vitin 2022, pasi kriteri vijon të jetë i njëjtë, si më parë, vetëm terminologjia/formulimi ka ndryshuar.

Në analizë të informacionit të sipërcituar, Komisioneri vëren se pavarësisht ndryshimeve të bëra në vitin 2022, të pikës 2.1 c), në VKM-në nr. 666/2019, ku parashikohet trajtimi me bursë i fëmijëve të familjeve në pamundësi ekonomike, sërish nuk del i qartë synimi i Këshillit të Ministrave, në zbatim të vendimit të Komisionerit, për trajtimin me bursë të kësaj kategorie për të përfituar si kategori më vete, pavarësisht nëse e braktis apo jo shkollën apo kanë distancë nga vendbanimi.

Në rastin konkret, janë parashikuar si kategori të veçanta: nxënësit me statusin e jetimit; nxënësit që kanë humbur kujdestarinë ligjore; nxënësit me aftësi të kufizuara; nxënësit e personave që kanë statusin e invalidit; nxënësit që kanë humbur kujdesin prindëror; nxënësit, fëmijë të punonjësve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës; nxënësit me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton; ndërsa fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, nuk janë përcaktuar si kategori më vete.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se për të siguruar arsimin gjithëpërfshirës, për të gjithë fëmijët e familjeve në nevojë, shteti nëpërmjet akteve nënligjore duhet të marrë masa për të parandaluar braktisjen shkollë, përpara se ajo të ndodhë dhe jo pasi të këtë ndodhur të trajtojë me bursë, nxënësit që janë braktisës së shkollës.

Në vlerësim të Komisionerit, fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, pavarësisht ndryshimeve të bëra në vitin 2022, të pikës 2.1 c), në VKM-në nr. 666/2019, janë trajtuar në mënyrë të pafavorshme krahasuar me grupet e tjera si fëmijët me statusin e jetimit, ato me aftësi të kufizuara apo grupet e tjera që përfitojnë nga kjo VKM, e ndryshuar. Në përmbajtje, ndryshimi i bërë në vitin 2022, në VKM-në nr. 666/2019, nga ana e Këshillit të Ministrave, nuk solli asnjë risi në zbatimin e saj, duke mbetur sërish kufizuese dhe në të njëjtën logjikë me VKM-në e mëparshme nr. 666/2019, për të cilën Komisioneri kërkoi rishikimin e saj.

Sakaq, VKM-ja e sipërcituar, evidentohet se nuk është e qartë dhe e kuptueshme nga organet të cilat vendosen përpara përgjegjësisë për ta zbatuar atë. Duke qenë e paqartë, vendos përpara vështirësisë institucionet/organet përgjegjëse në sjelljen që duhet të mbajnë për zbatimin e saj.

**Sa më sipër Komisioneri vlerëson se, fakti që kategori të tjera që përfitojnë për shkak të statusit, janë bërë pjesë e VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar në vitin 2022, si kategori të veçanta dhe kategoria e fëmijëve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, është parashikuar si një kategori përfituese, vetëm duke plotësuar disa kushte shtesë, ka vënë këta të fundit në kushte të pabarabarta me kategoritë e tjera përfituese, si dhe nuk është bazuar në politikat e hartuara nga shteti shqiptar për të siguruar arsimin gjithëpërfshirës dhe krijimin e shanseve dhe mundësive të barabarta në shoqërinë shqiptare.**

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18 (2)), askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën për të mos u diskriminuar bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet



politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të racës, ngjyrës, etnisë, gjendjes ekonomike, gjendjes arsimore, gjendjes familjare dhe përkatësisë në një grup të veçantë, të pretenduar nga ankuesi si shkaqe diskriminuese, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në rastin në fjalë, pretendohet se nxënësit<sup>15</sup> e përfaqësuar përpara Komisionerit nga ana e Qendrës për Advokim Social, janë diskriminuar për më shumë se një shkak dhe konkretisht, për shkak të *racës, ngjyrës, etnisë, gjendjes ekonomike, gjendjes arsimore, gjendjes familjare dhe përkatësisë në një grup të veçantë.*

Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkakun i pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak.

- i. ***Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të racës, etnisë dhe ngjyrës,*** Komisioneri vlerëson se “*raca, etnia dhe ngjyra*” parashikohen shprehimisht si shkaqe të mbrojtura nga neni 1, i LMD.

Përkufizimi më gjerësisht i pranuar mbi racën është ai i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e Gjithë Formave të Diskriminimit Racor. Në nenin 1, kjo Konventë definon diskriminimin racor si çdo dallim, përjashtim ose privilegjim në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës ose origjinës nacionale ose etnike, që ka për qëllim pamundësimin ose vështirësimin të pranimit, gëzimit apo ushtrimit të bazës së barabartë të të drejtave dhe lirive bazë të njeriut në fushën e jetës ekonomike, shoqërore, kulturore, si dhe fusha tjera të jetës

<sup>15</sup> A. A., O. G., A. G., B. T., K. Z. dhe A. Z.

publike<sup>16</sup>. Në kontekstin rajonal evropian, me rëndësi është përkufizimi i Komisionit Evropian kundër racizmit dhe tolerancës (ECRI), sipas së cilit, racizmi dhe diskriminimi racor lidhen me bazat racë, ngjyrë të lëkurës, fe, nacionalitetet ose origjinë nacionale ose etnike<sup>17</sup>.

Përkatësia etnike shpesh konsiderohet si pjesë e diskriminimit racor. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KDESK) konsideron përkatësinë etnike si shkak të mbrojtur për diskriminim, dhe si pjesë të mbrojtjes nga diskriminimi në bazë të racës dhe ngjyrës së lëkurës<sup>18</sup>. Sipas GjEDN-së, përkatësia etnike nxjerr origjinën nga idea mbi grupet shoqërore, tipari kryesor i të cilave është origjina e përbashkët nacionale, lidhshmëria me një fis të caktuar (ang. tribe), bindje fetare, gjuhë të përbashkët, ose origjinë dhe prapavijë kulturore dhe tradicionale<sup>19</sup>.

GJEDNJ-ja në çështjen Timishev kundër Ruisë , ka mbajtur qëndrimin se:

*“Përkatësia etnike dhe raca janë koncepte të lidhura dhe të mbivendosura. Megjithëse nocioni i racës është i rrënjosur në idenë e klasifikimit biologjik të qenieve njerëzore në nënspecie sipas karakteristikave morfologjike të tilla si ngjyra e lëkurës apo karakteristikat e fytyrës, përkatësia etnike e ka origjinën e vet në idenë e grupeve shoqërore të shënuar nga kombësia e përbashkët, përkatësia fisnore, besimi fetar, gjuha e përbashkët, ose origjina dhe prejardhja kulturore dhe tradicionale<sup>20</sup>”*

Në lidhje me provueshmërinë e shkakut të “racës” pala ankuese depozitoi edhe vërtetimin e datës 11.07.2023, të lëshuar nga ana e Qendra për Advokim Social, sipas të cilit vërtetohet se nxënësit A. A., O. G., A. G., B. T., K. Z. dhe A. Z., janë anëtarë që i përkasin Pakicës Kombëtare Egjiptiane të Shqipërisë.

Sa më sipër, Komisioneri konsideron plotësisht të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të “racës”, pasi subjektet e përfaqësuar nga Qendra për Advokim Social, i përkasin Pakicës Kombëtare Egjiptiane të Shqipërisë.

ii. ***Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”,*** Komisioneri vlerëson se “gjendja ekonomike” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD. Gjendja ekonomike, si shkak i ndaluar diskriminimi, kryesisht lidhet me individë, grupe individësh apo grupe shoqërore, të cilët janë në pamundësi ekonomike për të përballuar një jetesë dinjitoze dhe kjo pamundësi reflekton pastaj në braktisjen e shkollës ose në arritjet e nxënësve.

<sup>16</sup> Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor. Neni 1

<sup>17</sup> ECRI General policy recommendation No. 7 on national legislation to combat racism and racial discrimination. Council of Europe Website. <[http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/activities/gpr/en/recommendation\\_n7/ecri03-8%20recommendation%20nr%207.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/activities/gpr/en/recommendation_n7/ecri03-8%20recommendation%20nr%207.pdf)>.

<sup>18</sup> Komenti i përgjithshëm nr. 20 i Komitetit për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. parag.19

<sup>19</sup> Timishev v Russia (2007) 44 EHRR 776. para.55

<sup>20</sup> GJEDNJ, *Timishev kundër Ruisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragraf 55 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005, para. 55).

Komenti i Përgjithshëm nr. 20 “Mosdiskriminimi në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, i Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i Kombeve të Bashkuara, parashikon: “*Situata sociale dhe ekonomike e një personi kur jeton në varfëri ose është i pastrehë mund të rezultojë në diskriminim të përhapur, stigmatizim dhe stereotipe negative që mund të çojnë në refuzimin ose aksesin e pabarabartë për të njëjtën cilësi të arsimit dhe kujdesit shëndetësor si të tjerët, si dhe mohim ose akses të pabarabartë në vendet publike*”.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, kategoria e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, dhe kanë fëmijë që ndjekin arsimin bazë, është kategori e familjeve në nevojë që e mbartin shkakun e mbrojtur.

iii. ***Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, gjendjes familjare dhe përkatësisë në një grup të veçantë***, subjekti ankues nuk vuri në dispozicion të shqyrtimit të çështjes asnjë informacion apo provë, për të argumentuar ekzistencën e këtyre shkaqeve apo se si ato kanë ndikuar në sjelljen diskriminuese të pretenduar. Për rrjedhojë, Komisioneri e vlerëson të pabazuara shkaqet e “*gjendjes arsimore, gjendjes familjare dhe përkatësisë në një grup të veçantë*”.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi për diskriminim duhet të shqyrtohet bazuar në shkakun e *racës* dhe *gjendjes ekonomike*, pasi konsiderohen të provuara mbështetur në provat dhe faktet e administruara.

### **C. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.**

#### **C.1 Lidhja e trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm, me shkakun e gjendjes ekonomike.**

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon: “*1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive*”.

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në

trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet<sup>21</sup>. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme<sup>22</sup>. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme<sup>23</sup>. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar “pabarazitë faktike” ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14<sup>24</sup>.

Në nenin 3, pika 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Në nenin 6, të LMD përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

<sup>21</sup> Shih: Molla kundër Greqisë, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; Fábián kundër Hungarisë, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1985, prg.72.

<sup>22</sup> Shih: Çështja Thlimmenos kundër Greqisë [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

<sup>23</sup> Shih: Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

<sup>24</sup> Shih: Çështjen Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen Thlimmenos, cituar më lart, prg. 44; Çështjen D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se : *“7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”*. Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit në punësim dhe profesion e bën edhe Kodi i Punës, duke sanksionuar në nenin 9, pika 10, të tij se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”*, si dhe Kodi i Procedurave Administrative, duke parashikuar në nenin 82, pika 2, si vijon: *“2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni e ka zhvendosur barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se prima facie është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, fillimisht duhet të krijohet një prezumim i diskriminimit (diskriminimi prima facie), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njëren nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.<sup>25</sup>

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në kushtet kur, Komisioneri ka arritur në përfundimin se, fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, dhe nuk janë braktisës së shkollës, i janë nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm, rezulton i provuar trajtimi i pafavorshëm i kësaj kategorie të nxënësve. Në këto

<sup>25</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

kushte, mbetet që të vlerësohet nëse për këtë diferencë në trajtim ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Identifikimi i të gjitha shkaqeve të diskriminimit dhe analizimi i tyre në një çështje diskriminimi është mjaft i rëndësishëm, jo thjesht për të performuar diskriminimin e shumëfishtë, por edhe për të dhënë një vendim sa më efektiv. Në çështjen në shqyrtim, Komisioneri ka identifikuar dhe vlerësuar se subjekti ankues posedon më shumë se një shkak të mbrojtur nga LMD, atë të “racës” dhe “gjendjes ekonomike”.

Komisioneri vlerëson se, qëllimi i Këshillit të Ministrave për trajtimin me bursë të nxënësve që braktisin shkollën apo nuk e frekuentojnë atë, është i ligjshëm, pasi synon uljen e numrit të nxënësve që braktisin shkollën.

Në analizë të të dhënave të analizuara në vendimin e Komisionerit me nr. 148, datë 22.07.2022, rezultoi se dhënia e këtyre bursave nuk kishte ndikuar në uljen e braktisjes shkollore dhe numri i fëmijëve që kishin përfituar këtë mbështetje financiare ishte sa 10% e numrit të fëmijëve që kanë braktisur shkollën.

Pra, në vendimin e sipërcituar, Komisioneri vlerësoi se politika e mbështetjes me bursë e fëmijëve që braktisin shkollën, si me fondet e qeverisë qendrore ashtu dhe asaj vendore, nuk kishte rezultuar efikase dhe nuk kishte arritur qëllimin për të cilën është hartuar.

Pas vendimmarrjes së Komisionerit dhe ndryshimit të VKM-së nr. 666/2019, në vitin 2022, subjekti ankues, pretendoi se kjo VKM, duhet rishikuar sërish, duke shtuar si kategori përfituese të veçantë, familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe familjet që kanë të ardhura nën pagën minimale.

Këshilli i Ministrave në zbatim të vendimit nr. 148, datë 22.07.2022 të Komisionerit, rishikoi VKM-në nr. 666/2019, në vitin 2022 duke bërë ndryshimet përkatëse, por Komisioneri gjykon se në thelb përsëri fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike nuk përfitojnë bursë financiare gjatë periudhës që ndjekin mësimin, por duhet të jenë në kushtet që nuk e ndjekin arsimin dhe pastaj të përfitojnë bursë.

E drejta për arsim, është një e drejtë themelore e njeriut, e sanksionuar në nenin 57<sup>26</sup> të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Shteti ka detyrimin që jo vetëm ta parashikojë, por edhe ta përmbushë këtë të drejtë duke e garantuar atë. Detyrimi për të përmbushur do të thotë që shteti duhet të marrë masa pozitive për të siguruar dhe lehtësuar gëzimin e të drejtave, sidomos për grupet shoqërore më të pamundura, të cilat në të kundërt, nuk do të kenë mundësi të kenë qasje në regjistrimin apo ndjekjen e arsimit e për rrjedhojë do të jenë përherë në kushtet e braktisjes së shkollës.

---

<sup>26</sup> 1. Kushdo ka të drejtën për arsimim. 2. .... 3. .... 4. .... 5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t'u arsimuar. Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës<sup>27</sup>, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, sanksionon të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta dhe shtetet palë duhet të marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

Ligji 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”<sup>28</sup>, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënës i duhet t'i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Këshilli i Ministrave për të garantuar të drejtën për arsim të të gjithë fëmijëve, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike si nga pushteti qendror dhe ai vendor, duhet të kishte parashikuar trajtimin me bursë të të gjithë fëmijëve që i përkasin kësaj kategorie, që janë në kushte të vështira ekonomike.

Në këto kushte, Këshilli i Ministrave, nuk arriti të provojë se ka një justifikim të arsyeshëm për mospërfshirjen e fëmijëve të familjeve të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike, në kategorinë e nxënësve që duhet të trajtohen me bursë, për ndjekjen e arsimit të detyrueshëm.

Për sa më sipër, Komisioneri konstaton se fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, janë vënë në pozita jo të favorshme, duke iu mohuar mundësinë për tu trajtuar me bursë, me qëllim sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës për të gjithë këto fëmijë.

Pra, ata janë vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, për shkak të gjendjes së tyre ekonomike.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

<sup>27</sup> Neni 28 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës<sup>27</sup>: 1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata: e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

<sup>28</sup> Neni 5. E drejta për arsimim. 1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.

Kushtetuta e Shqipërisë në Nenin 57 ka parashikuar se kushdo ka të drejtë për arsim dhe arsimit i detyrueshëm dhe arsimit i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas. Kushtetuta e Shqipërisë në nenin 59 të saj, nën rubrikën “*Objektivat socialë*”, ka parashikuar që Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon “*ç. Arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë*”. Gjithashtu, po e njëjta dispozitë parashikon që “*Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave*”.

Në këtë kuptim, bazuar në ligjin nr. 69/2012 “*Për arsimin parauniversitar*”, i ndryshuar, Ministria e Arsimit dhe Sportit, është autoriteti përgjegjës për të garantuar të drejtën për arsim në sistemin arsimor parauniversitar. Në bazë të nenit 25, të ligjit, funksionet kryesore të ministrisë janë që nëpërmjet hartimit të politikave, programeve dhe projekteve të zhvillojë sistemin arsimor parauniversitar.

Gjithashtu, neni 18, i ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ngarkon Ministrinë e Arsimit, dhe Sportit me përgjegjësi për marrjen e masave me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. Ndër të tjera Ministria e Arsimit dhe Sportit, është përgjegjëse për të marrë masa me karakter pozitiv me qëllim arsimimin e të gjithë popullsisë, në mënyrë të veçantë, duke marrë masa në favor të grave dhe vajzave, pakicave, personave me aftësi të kufizuar, si dhe personave që janë, ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij, përfshirë këtu edhe diskriminimin që mund të vijë për shkak të gjendjes ekonomike apo të racës.

Referuar arritjeve të bëra të njohura në Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve<sup>29</sup> (2021–2025), në të cilën është evidentuar fakti se është rritur numri i nxënësve romë dhe egjiptian që kanë ndjekur arsimin profesional, si rezultat i mbështetjes me bursë, Komisioneri vlerëson se e njëjta politikë duhet të ndiqet dhe për trajtimin me bursë të të gjithë fëmijëve të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, që ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike.

Plani Kombëtar i Veprimit “*Për Barazi, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe të Egjiptianëve, 2021–2025*”, u përgatit në emër të qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim dhe në konsultim me ministrinë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, si dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë për çështjet e integritit të romëve dhe të egjiptianëve në Shqipëri. Plani përputhet plotësisht me kornizën e re strategjike romë të BE-së për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje 2020–2030.

Dokumentit citon se, “*dhe me përpjekjet e qeverisë shqiptare dhe organizatave të tjera, të dhënat nga 5 vitet e mëparshme tregojnë se ekzistojnë ende probleme të regjistrimit civil, arsimit,*

---

<sup>29</sup> Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 701, datë 18.11.2021.



*punësimit, kujdesit shëndetësor, strehimit dhe mbrojtjes sociale. Këto probleme janë edhe më të mëdha kur shtohet stigma sociale aktuale, stereotipat dhe diskriminimi, që për fat të keq janë akoma të pranishme ndaj romëve dhe egjiptianëve. Romët dhe egjiptianët përballen me pengesa të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në aksesin e shërbimeve publike, të cilat lindin nga kriteret e pranueshmërisë që ata nuk mund t'i plotësojnë, nga mungesa e informacionit ose nga moskuptimi i procedurave administrative, si dhe nga stigmatizimi dhe diskriminimi i vazhdueshëm nga pjesa tjetër e popullatës. Përjashtimi afatgjatë ka ndikuar në kushtet e jetesës së romëve dhe egjiptianëve, në trajtimin diskriminues në disa raste nga pjesa tjetër e popullatës dhe në marrëdhënien me institucionet shtetërore”.*

Me miratimin e këtij dokumenti, Qeveria shqiptare merr përsipër obligimin që gjatë periudhës 2021–2025 të sigurojë përfshirjen sociale, ekonomike dhe kulturore të pakicave rome dhe egjiptiane në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet përcaktimit të prioriteteve strategjike dhe duke zbatuar politika të integruara. (Shiko p.sh. OSCE/ODIR (2013) praktikat më të mira për integrimin e romëve (BPRI).

Nga analiza e bërë më sipër, por edhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe të Egjiptianëve 2021–2025, rezulton se pakicat rome dhe egjiptiane në Shqipëri, përballen me pengesa të drejtpërdrejta në arsim për shumë arsye, ndër të cilat edhe gjendja ekonomike e tyre.

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026<sup>30</sup>, në vizionin e saj ka: *“Sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimin gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian”.*

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, ndër objektivat e saj specifik ka parashikuar dhe objektivin specifik A.2, ku citohet: *“Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve për të ulur braktisjen dhe për t’u mundësuar nxënësve të arrijnë potencialin e tyre të plotë;...”*

Gjithashtu, Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, ndër të tjera synon të sigurojë një kujdes të veçantë vajzave dhe djemve në rrezik braktisje, si dhe atyre nga grupet vulnerabël: fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe, në përgjithësi, nga grupet shoqërore të marginalizuara, vajzave dhe djemve që rikthehen nga emigracioni, fëmijët viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit, fëmijëve në konflikt me ligjin, si dhe pjesëtarëve të pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane<sup>31</sup>.

Një dokument tjetër strategjik i miratuar nga qeveria shqiptare me VKM-në Nr. 866, datë 24.12.2019, është dhe Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020-2023. Kjo strategji synon: *“... të përmirësojë mirëqenien fizike, shoqërore dhe ekonomike të individëve, fëmijëve dhe*

<sup>30</sup> Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 621, datë 22.10.2021.

<sup>31</sup> Paragrafi i fundit i faqes 61 të Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026.

familjeve, veçanërisht të atyre në kushte sociale ose ekonomikisht të pafavorizuara, duke garantuar shanse të barabarta dhe parimet e drejtësisë sociale. Strategjia synon reduktimin e varfërisë, sidomos varfërisë ekstreme, duke garantuar një jetesë dinjitoze për familjet/individin dhe fëmijët. Varfëria do të ulet, duke nxitur zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të tyre nëpërmjet adresimit të nevojave në kontekstin e rehabilitimit, integritit në tregun e punës dhe të shërbimeve shoqërore...

Paketa mbështetëse me subvencione shtesë/bonuse për vaksinimin dhe arsimimin e fëmijëve, si dhe ofrimi i paketës së ndihmës në natyrë tregon vëmendjen e shtuar për të asistuar familjen në tërësi duke integruar të gjitha llojet e shërbimeve publike... ”<sup>32</sup>.

Referuar analizës së situatës së ndihmës ekonomike, bërë në Kreun I të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020-2023, citohet se: “Bazuar në programin e Qeverisë Shqiptare, me mbështetjen e Bankës Botërore, MSHMS do të hartojë “Programin e daljes”, si një program i cili ka si qëllim ndërlidhjen e programeve të mbrojtjes sociale me skema të tjera nxitëse punësimi, duke u krijuar mundësinë e integritit në tregun e punës të anëtarëve në moshë pune në skemën e NE. Këtë qëllim programi i daljes synon ta realizojë nëpërmjet ndërthurjes/gërshetimit/integritit të paketës së plotë ligjore për ngritjen dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale me programet e nxitjes së punësimi dhe formimit profesional, si dhe përfshirjen e përfituesve të NE-së në politika zhvillimore territoriale (si zhvillimi rural, zhvillimi infrastrukturës apo shfrytëzimi i pyjeve dhe kullotave etj.).

Programi synon/krijon një mjedis miqësor për ndërthurjen e përfitimit të pagesave në para të NE-së me shërbime të tjera, drejt strukturimit të një pakete të plotë shërbimesh ndaj familjes/individit siç janë; i. shërbimet shoqërore për individin dhe familjen duke ofruar asistencë/shërbime në shtëpi për të moshuar, personat me aftësi të kufizuara etj.; ii. ndihmën në natyrë për familjet/individët ekstremisht të varfër; iii. arsimimi dhe kujdesi shëndetësor”.

Në analizë për sa më sipër, me miratimin e këtyre dokumenteve strategjik, Qeveria shqiptare merr përsipër obligimin të sigurojë përfshirjen sociale, ekonomike dhe kulturore, ndër të tjera edhe paketa mbështetëse për arsimimin e fëmijëve që vijnë nga familje në nevojë duke i garantuar atyre një jetesë sa më dinjitoze.

Bazuar në aktet e administruara dhe konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, faktet dhe provat e administruara krijojnë bindjen se, subjektet ankues, fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, janë vënë në pozita diskriminuese nga parashikimi i VKM-së 666/2019, të ndryshuar, si kategori në nevojë për shkak të gjendjes ekonomike, duke i vendosur kriteret shtesë dhe duke mos parashikuar trajtimin me bursë, pavarësisht ndryshimeve të bëra në këtë VKM në vitin 2022.

Për rrjedhojë, Komisioneri arrin në përfundimin se MAS-i, si institucioni përgjegjës për hartimin e politikave të zhvillimit të sistemit arsimor, duhet të marrë iniciativën, për përfshirjen e të gjithë

<sup>32</sup> Paragrafi i 2,3 dhe 5 i cituar në faqen 2 të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020-2023.

nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, në kategorinë e nxënësve që duhet të përfitojnë bursë, gjatë periudhës së ndjekjes së shkollës.

## **C. 2 Lidhja e trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm, me shkakun e racës.**

Mbështetur në analizimin e fakteve e provave të depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjektet ankues, fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, janë vënë në pozita diskriminuese nga parashikimi i VKM-së 666/2019, të ndryshuar, si kategori në nevojë për shkak të gjendjes ekonomike, duke i vendosur kritere shtesë dhe duke mos parashikuar trajtimin me bursë, pavarësisht ndryshimeve të bëra në këtë VKM në vitin 2022.

Referuar informacionit të administruar dhe analizës së VKM-së 666/2019, të ndryshuar, konstatohet se nga kjo VKM, nuk përfitojnë bursë duke i vendosur kritere shtesë dhe duke mos i parashikuar si kategori e veçantë, fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike. Sakaq, Komisioneri evidenton se fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, janë nxënës që vijnë nga familje në nevojë dhe jo vetëm nga familje që i përkasin një pakice kombëtare apo pakicave egjiptiane në Shqipëri. Vetë VKM-ja nr. 666/2019, e ndryshuar, ka parashikuar si kategori përfituese të veçantë, nxënësit që vijnë nga pakicat kombëtare rome dhe egjiptiane, në pikën 2.3 “*Kriteri joekonomik*”, ku përcaktohet se: “...*dh) nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane, të cilët regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional;*”.

Shkaku i racës, gëzon mbrojtje ligjore si shkak i parashikuar në LMD, mirëpo, gjatë procedurës hetimore të shqyrtimit të ankesës nuk u arrit të provohej që pikërisht ky shkak kishte shërbyer si shkak që ata të ishin trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme nga institucionet e sipërpërmendur apo VKM-ja nr. 666/2019 e ndryshuar.

Për rrjedhojë, KMD vlerëson se, pretendimet e subjektit ankues, Qendrës për Advokim Social, për diskriminim bazuar në këtë shkak, nuk krijojnë prezumimin mbi bazën e provave të drejtpërdrejta apo të tërthorta të sjella prej saj, që sjellja e subjekteve ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, kundrejt fëmijëve që vijnë nga familje që i përkasin pakicës egjiptiane në Shqipëri, të jetë motivuar nga shkakun sipërcituar.

Sa më sipër Komisioneri nuk arriti të provojë se trajtimi i padrejtë e i pafavorshëm i nxënësve A. A., O. G., A. G., B. T., K. Z. dhe A. Z., nga ana e Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Tiranë, të kishte ardhur për shkakun sipërcituar (për shkak të përkatësisë në pakicën kombëtare egjiptiane).

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7/1, nenin 11, nenin 18/1, nenin 32, pika 1, germa b) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të nxënësve A. A., O. G., A. G., B. T., K. Z. dhe A. Z., si fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Këshillit të Ministrave.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit të nxënësve A. A., O. G., A. G., B. T., K. Z. dhe A. Z., nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Tiranë.
3. Këshilli i Ministrave të marrë masa, për rishikimin e VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar në vitin 2022, duke shtuar trajtimin me bursë pa kushte shtesë, të nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike.
4. Për të shmangur situatën e krijuar në rastin konkret, rekomandohet Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, të marrin masa, për një bashkëpunim më intensiv dhe të frytshëm, për koordinimin dhe konsultimin mes pushtetit vendor dhe atij qendror, gjatë procesit të hartimit të politikave gjithëpërfshirëse apo akteve ligjore/nënligjore, në mënyrë që ato të jenë të qarta dhe të zbatueshme nga institucionet përgjegjëse.
5. Në referim të nenit 33, pika 13, të Ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Gjendja ekonomike)  
(Fusha: Të mira dhe shërbime)